

## Programi për fëmijë dhe rekreacion

A dëshiron të punosh me njerëz?

A dëshiron të mësosh se si t'ju japësh fëmijëve, rinisë dhe të moshuarve një kohë të lirë agrëtuese?

A dëshiron të dijs se sit ë organizosh dhe t'i udhëheqësh aktivitetet që i zhvillojnë njerëzit?

A dëshiron të provosh të punosh që nga koha e gjimnazit?

A dëshiron t'i vazhdosh studimet pas gjimnazit?

Atëherë Programi për fëmijë dhe rekreacion mund të jetë për ty.

Edhe pse quhet "Programi për fëmijë dhe rekreacion", do të mësosh se ti të punosh me njerëz të të gjitha moshave. Ndoshta ke dëshirë të punosh duke iu argëtuar jetën të moshuarve, ose duke takuar dhe duke i udhëhequr ata me aftësi të kufizuara. Bazat e një punë të atij lloji mund t'i mësosh te Programi për fëmijë dhe aktivitete të kohës së lirë.

## Të punosh apo t'i vazhdosh studimet

Programi për fëmijë dhe rekreacion nuk është direkt përgatitës për profesione. Që të pranohesh në një punë që të intereson ndoshta do të duhet të studiosh edhe pak më tepër, për shembull në fakultet apo në një kualifikim tek Fakulteti i profesioneve.

## Punë ku mund të pranohesh

Pasi që e mbaron Programi për fëmijë dhe rekreacion, i ke krijuar bazat e mira për një punë tek pishinat ose sallat sportive, ose si një udhëheqës i aktiviteteve. Nëse dëshiron t'i vazhdosh studimet, ke shumë mundësi të ndryshme. Mund të shkollohesh për kujdestar të fëmijëve, asistent të nxënësve, mësues, polic, rroje, kujdestar në burgje, pedagog social, shërbyes në kishë, socionom, psikolog, udhëheqës rekreacioni, dijetar rekreacioni dhe udhëheqës sportesh. Mund të zgjedhësh edhe të vazhdosh shkollimet në turizëm.

Programi përbëhet nga dy drejtime kombëtare. Kjo do të thotë të gjithë ata që sutidojnë në tërë vendin kanë mundësi t'i zgjedhin drejtimet. Përveç këtyre, mund të keete edhe drejtime tjera në disa gjimnaze. Ndoshta ka diçka që të përshtatet ty më së miri. Pyete urdhërrëfyesin tënd të studimeve dhe të profesioneve!

Dy drejtimet kombëtare janë

Aktivitete pedagogjike dhe sociale – për ty që dëshiron të specializohesh në lëminë e mësimit dhe zhvillimit të fëmijëve ose që dëshiron të mësojë më tepër në lidhje me punë sociale të njerëzve të të gjitha moshave.

Rekreacion – për ty që dëshiron të specializohesh për kulturë dhe rekreacion dhe që dëshiron të mësosh se si t'i planifikosh dhe t'i udhëheqësh aktivitetet e të rinjve dhe të rekreacioneve.

## Kontake me tregun e punës

Te Programi për fëmijë dhe të rekreacioneve ke mundësi që t'i ndikosh vetë studimet e tua. Në këtë mënyrë do të jepet mundësia që vetë të marrësh përgjegjësi dhe si të planifikosh. Do të keshë poashtu edhe shumë kontakte me botën përreth jashtë shkollës. Ndoshta bashkëpunon shkolla yte me një shoqatë, kështu që një herë do të studiosh një lëndë, i teston dituritë në shkollë dhe pastaj në realitet e krahason një projekt të vërtetë tek shoqata.

Gjatë kohës në gjimnaz, do të keshë të paktën 15 javë kualifikim në vende të punës (APU). Kjo do të thotë se gjatë një pjese të kualifikimit tënd do të jepet mundësia që të marrësh pjesë në një apo disa vende pune ku do të mund t'i provosh dituritë e tua në realitet. Kjo është një mënyrë e mirë për të patur kontakte që më pas mund t'i përdorësh kur do të kërkosh punë. Nëse të intereson ta bësh APU-në tënd në një vend tjetër përveç Suedisë, atëherë do të keni mundësi për këtë.

## **Ardhmëri dhe punë**

Shumica e atyre që kanë mabruar Programin për fëmijë dhe rekreacion i kanë vazhduar studimet në fakultet pas gjimnazit. Shumë të tjerë janë kualifikuar si kujdestar fëmijësh ose kujdestar në kopshte, që më pas të mund të punojnë nëpër parashkollë. Kur shumica kualifikohen me shkollime të larta, vështërsohen kushtet për ato që vetëm kanë mbaruar gjimnazin që të gjejnë punë. Tani për tani nuk ka shumë që i vazhdojnë studimet. Për këtë arsye mund të jetë e mundur që të pranohesh në punë menjëherë pasi që e mbaron gjimnazin. Por është e vështirë të themi se si do të jetë ardhmëria pas disa vitesh.